

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dëgjimet komuniste të Ramës për Reformën Territoriale
ADRESA	https://www.cna.al/opinione/degjimet-komuniste-te-rames-per-reformen-territoriale-i474143
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:10:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 15:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	78987cfe4dc1d92d5dc4a0e0f0830cea948fcf28059b3776f9fc8605a208c910
TEKSTI	20fa085c4f720f0f9de3422ac641f9ebe99ce19dee1bee23e926542ac8325255
PAMJA	927dd931d76017a934bfc34c7a21589e7fdeaf0ed6a6b2eb949f09a564eabb47

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cf9d1c15325732d448a9f6f3bcacd147088d551f4c6152365c6712427eae5981
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abaeffa87f787
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cf9d1c15325732d448a9f6f3bcacd147088d551f4c6152365c6712427eae5981>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

17:54 Aktualitet

Një ditë para seancës për kryebashkiakun e arrestuar të Ti...

Dëgjimet komuniste të Ramës për Reformën Territoriale



14 Shtator 2026, 17:57, Opinione Sherefedin Shehu



Dëgjesat në demokraci bëhen për të informuar vendimmarrjen, ndërsa Rama, ashtu si etërit e tij politikë, i bën për të imponuar vendimmarrjen e tij.

Ato që po shikojmë këto ditë janë "dëgjesa politike" që Rama i bën për propagandë, kërcënim dhe imponim. E vërteta është se dëgjesat për reformën u bënë nga komisioni gjithëpërfshirës dhe Rama i hodhi në kosh.

Mediata dhe këto dëgjesa janë politike dhe i interesojnë vetëm Ramën. Kudo ku shkon ai shikohet si shprehje e dështimit të reformës territoriale dhe të shtetit në tërësi.

megjithatë këto dëgjesa janë politike dhe i interesojnë vetëm njerëzit, kudo ku shkon ai shkonet një mobilizim politik tërthorës për të luajtur qendrueshmëri e paracaktimit, si duket, dhe për të penguar pjesëmarrjen në dëgjesa të "personave të padëshiruar" për Ramën ose siç quheshin dikur "anti-parti".

Në dëgjesat e Ramës marrin pjesë vetëm të paracaktuarit dhe nxirret jashtë kushdo që kundërshton me argumente dëmet dhe synimet politike të Rama-Reformës. Në këto gjoja dëgjesa publike ai vetëm flet dhe nuk dëgjon asnjë, dhe çudia e fundit e tij është që Bashkitë që po i shkrin thotë se nuk do të jenë njësi administrative por qytete. Kjo është PROPAGANDË TIPIKE KOMUNISTE, sepse:

1. Shqipëria nuk ka ligj që i njeh QYTETET si njësi vetëqeverisëse me status të përcaktuar për burimet ekonomiko-financiare të lokalitetit dhe vendimarrjen për mobilizimin dhe përdorimin e tyre.

2. QYTETET dhe Njësitë administrative janë pjesë e administratës Bashkiake dhe nuk kanë asnjë Status ligjor të veçantë dhe lidhje me konceptin dhe sistemet moderne të vetëqeverisjes lokale.

3. Bashkimi Europian ka një sistem të vetëqeverisjes lokale me dy nivele, niveli parë dhe niveli i dytë, përkatësisht:


a. Niveli i parë janë Bashkitë dhe ish-Komunat të cilat kanë të njëjtin status por me një ndryshim që te parat operojnë në zonat urbane dhe të dytat në zonat rurale. Pra, emërtimi nuk bën diferencë por diferenca qëndron në teritorin ku operon dhe bazohet kryesisht në nevojat e ndryshme për shërbime publike, mundësitë e pabarabarta për të siguruar burimet e veta ekonomiko-financiare dhe politikat e diferencuara që duhet të ndërmerren nga Qeveria Qendrore për zbutjen e pabarazisë natyrore.

b. Niveli i dytë janë Rajonet, që veprojnë në teritorin e disa Bashkive dhe Komunave por kanë Role dhe Përgjegjësi të ndara. Ato ushtrojnë kryesisht funksione që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik rajonal dhe efektivitetin e "ekonomisë së shkallës". Kjo e fundit nënkupton shërbime të cilat mund të ofrohen me cilësi më të mirë dhe me kosto më të ulët në një teritor më të gjërë dhe për një numër më të madh të përfituesve të shërbimeve.

4. Vetëm kryeqytetet mund të kenë status të veçantë, por të përcaktuar specifikisht me ligj. Në thelb ato janë Bashki, por me një status preferencial.

5. Kategoria e "QYTETIT" është Mashttrimi i Radhës i Ramës. Niveli i Qytetit nuk ekziston as në BE, as në Botë dhe as në Ligjin Shqiptar të Vetëqeverisjes Lokale. Ky mashttrim i Ramës synon Uzurpimin e Qeverisjes Lokale, Thellimin e Varfërisë në Zonat Gjysëm-Urbane dhe Rurale, Shpopullimin e këtyre zonave dhe Sundimin apo Kontrollin më të lehtë të tyre.

Mos harroni! Thelbi i reformës qëndron tek vendimarrja. Kush vendos për ty dhe për çfarë vendos. Qytetet, siç thotë një shprehje popullore, do të kenë "ÇELËSAT E KASHTËS". Prandaj, Rama nuk duhet dëgjuar më. Mjaftojnë të thënat dhe bëmat e tij për 16 vite për të kuptuar se kush është ay. Kuft nuk i mjaftojnë le të vazhdojë të kënaqet me të.





Të sugjeruara

Keqkuptimi me takimet e së premtes!

Jo kundër Muzeut Hebraik në Vlorë, por kundër histerisë rreth tij

Kush është Ron Yeffet dhe çfarë pushteti ka në Shqipëri?

GJYSH, TË FALËM!

"Timak Defence", para se të kërcënoni median, tregoni se çfarë bëni

Azem Hajdari

Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare

Nga zv/ministër i guriçkave në dallkauk, haxhiqamilist

Një propozim modest për protestuesit

FEMINIZMI SI ALIBI

Përpara pasqyrës apo iluzionit mashtrues?

Irimi është që Ukraina i blen makinat dhe armët me tenderat

[Shqipëria në shitje dhe Masakra e Koplikut si tradhti kombëtare](#)

[Shqipëria në shitje dhe Masakra e Koplikut si tradhti kombëtare](#)

[Inteligjenca Artificiale dhe teknologjia tek fëmijët](#)

[Prania Besnike e Zeqinesë!](#)

[Bilanci njëvjeçar i Diellës](#)

[Kali i Kaligulës](#)

[Përtej lëndimit të Natasha Lakos dhe Mevlan Shanajt](#)

[Hap pas hapi/ Si lexohet deklarimi i pasurisë pa u mashtruar](#)


[Pasqyrë moj Pasqyrë, si do t'i vejë halli hallit tim?](#)

[editorial](#)

16:28 Editorial Elvi FUNDO

[Edhe një herë për deputetin analfabet dhe “mbështetësit” e tij](#)

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në





[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.